



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 1.2.2023

Nr: 23

Ora: 10:30

V E N D I M

P Ë R

**PROCEDURAT DHE KRITERET E AKREDITIMIT TË VËZHguesVE TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE
NË KOMISIONET E ZONAve TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR, KOMISIONET E QENDRAVE TË
VOTIMIT DHE VENDET E NUMËRIMIT TË VOTAVE, NË ZGJEDHJE**

Në mbështetje të nenit 6, pikat 1, 4 e 6, nenit 7, nenit 19, shkronja “n”, nenit, 116, pika 6, nenit 118, nenit 122, pika 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e procedurave dhe kriterëve të akreditimit të vëzhguesve të subjekteve zgjedhore në Komisionin e Zonës së Administrimit Zgjedhor (ZAZ), Komisionin e Qendrës së Votimit (KQV) dhe në Vendin e Numërimit të Votave (VNV).

Neni 2

Kriteret për të qenë vëzhgues

1. Vëzhgues mund të jetë çdo shtetas shqiptar i propozuar nga një subjekt zgjedhor për vëzhgimin e procesit zgjedhor në KZAZ, QV, VNV.
2. Vëzhguesi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
 - a) gëzon të drejtën për të qenë zgjedhës;
 - b) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

Neni 3

Të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve

1. Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, vëzhguesit kanë këto të drejta:
 - a) të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve dhe të gjitha fazat e procesit zgjedhor,
 - b) të paraqesin vërejtje me shkrim para komisioneve të zgjedhjeve për çdo lloj parregullsie që vërejnë,
 - c) të shohin ose të këqyrin dokumentacionin ose materialet e procesit zgjedhor.

2. Vëzhguesit kanë këto detyra:
 - a) të respektojnë kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe vendimet e KQZ-së për vëzhgimin e zgjedhjeve, si dhe vendimet dhe urdhërimet e KZAZ-së ku janë akredituar,
 - b) të mos bëjnë propagandë për asnjë kandidat, parti ose koalicion në ambientet zgjedhore;
 - c) të paraqiten para komisioneve të zgjedhjeve me autorizimin përkatës, të shoqëruar me dokumentin e identifikimit (pasaportë, kartë identiteti),
 - ç) të mos mbajnë shenja dalluese që shërbejnë si propagandë ose që mund të ndikojnë mbi vullnetin e zgjedhësit,
 - d) të mos dhunojnë të drejtën e votuesit për të votuar në fshehtësi dhe të mos pengojnë procesin e votimit dhe numërimit të votave,
 - dh) të qëndrojnë në vendin e caktuar për vëzhguesit nga KZAZ-ja dhe në asnjë rast të mos afrohen pranë dhomës së fshehtë,
 - e) të respektojnë rregullat e etikës në marrëdhëniet me komisionerët zgjedhor dhe vëzhguesit e tjerë, të mos komentojnë me zë dhe të mos debatojnë lidhur me zhvillimin e procesit të votimit,
 - ë) të mbajnë gjatë gjithë kohës në vend të dukshëm autorizimin e vëzhguesit,
 - f) të mos shënojnë apo dokumentojnë me çfarëdo mënyre e mjeti, brenda ambienteve të qendrës së votimit të dhëna që mund të çojnë në identifikimin e zgjedhësve që po votojnë, kanë votuar apo do të votojnë.

3. Vëzhguesit e subjekteve zgjedhore të akredituar në VNV përveç të drejtave të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni kanë edhe këto të drejta:
 - a) të njoftojnë KZAZ-në (njoftimi bëhet me ngritjen e dorës) në rast të konstatimit të pasaktësive ose parregullsive gjatë procesit të numërimit të votave (gjatë verifikimit të materialeve zgjedhore që gjenden në Kutinë e Materialeve Zgjedhore dhe verifikimit të të dhënave për numrin e fletëve të votimit në kutinë e votimit) sipas nenit 116, të Kodit Zgjedhor,
 - b) të kundërshtojnë (kundërshtimi bëhet me ngritjen e dorës) vlerësimin e votës së bërë nga numëruesi i parë i GNV-së, sipas përcaktimeve të pikës 2, paragrafi i tretë, të nenit 118, të Kodit Zgjedhor,

- c) të marrin kopje të tabelës përmbledhëse të rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së, tabelave të rezultateve të QV-ve dhe kopje të procesverbaleve të konstatimit.

Neni 4

E drejta për të caktuar vëzhgues

1. Çdo parti politike e regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) si subjekt zgjedhor, ka të drejtë të caktojë nga një vëzhgues në KZAZ, KQV dhe për çdo tavolinë në Vendin e Numërimit të Votave.
2. Të drejtën për caktuar vëzhgues e ka subjekti zgjedhor që ka regjistruar listë shumëmemërore, sipas rastit në KQZ/KZAZ.
3. Për partitë politike që marrin pjesë në zgjedhje si koalicion, të drejtën për të caktuar vëzhgues e ka vetëm partia udhëheqëse e koalicionit. Koalicioni ka të drejtë të caktojë jo më shumë se 3 vëzhgues për KZAZ, KQV dhe për çdo tavolinë në Vendin e Numërimit të Votave.
4. Kandidatët e subjekteve zgjedhore nuk kanë të drejtë të caktojnë vëzhgues.
5. Kandidati i propozuar nga zgjedhësit ka të drejtë të caktojë nga një vëzhgues në KZAZ, në KQV dhe në VNV në zonën zgjedhore përkatëse.

KREU II

PROCEDURA E AKREDITIMIT TË VËZHguesVE NË KQZ

Neni 5

Dorëzimi i dokumentacioni për akreditimin e vëzhguesve

1. Subjekti zgjedhor dorëzon në KQZ dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Kërkesën për akreditimin e vëzhguesve të nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar nga partia politike, partia udhëheqëse e koalicionit apo kandidati i propozuar nga zgjedhësit. Akti i autorizimit depozitohet në KQZ.
 - b) Vërtetimin që është regjistruar si subjekt zgjedhor dhe ka regjistruar kandidatë në zgjedhje.
 - c) Listën e vëzhguesve që kërkohet të akreditohen pranë KZAZ-së/KQV-së/VNV-së përkatëse. Lista duhet të jetë e nënshkruar në çdo faqe nga kryetari i partisë politike ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij, i partisë udhëheqëse të koalicionit ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij, apo nga kandidati i propozuar nga zgjedhësit ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij. Lista dorëzohet sipas modelit KQZ 04 - 19, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - ç) vetëdeklarimin e vëzhguesit për gjendjen gjyqësore, sipas modelit KQZ 04-20, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kërkesat e subjekteve zgjedhore për akreditimin e vëzhguesve i paraqiten KQZ-së, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve.
3. Subjekti zgjedhor që dorëzon kërkesën për të akredituar vëzhgues mban përgjegjësi për saktësinë e dokumentacionit të paraqitur dhe për të dhënat personale të paraqitura për secilin prej vëzhguesve të propozuar.

Neni 6

Verifikimi i dokumentacionit dhe vendimmarrja e KQZ-së

1. KQZ-ja verifikon dokumentacionit e dorëzuar për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore mbi bazën e të dhënave vetjake të çdo vëzhguesi, brenda 2 (dy) ditëve nga paraqitja.
2. Në rast të konstatimit të mangësive në dokumentacionin e paraqitur, në përmbajtje ose në formë, KQZ-ja ia kthen për plotësim/korrigjim subjektit zgjedhor përkatës.
3. Dokumentacioni i plotësuar/korrigjuar ridepozitohet pranë KQZ-së, brenda 24 (njëzetë e katër) orëve nga shpallja e vendimit të kthimit.
4. Verifikimi i dokumentacionit të plotësuar/korrigjuar kryhet nga KQZ-ja, brenda 24 (njëzetë e katër) orëve nga ridepozitimi i tij.
5. KQZ, sipas rastit, miraton ose refuzon kërkesën e subjekteve zgjedhore për akreditimin e vëzhguesve, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga paraqitja e tyre.
6. Pas marrjes së vendimit për akreditim, KQZ pajis vëzhguesit me autorizimin e akreditimit, sipas modelit KQZ 09 – 16, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
7. Kundër vendimit të KQZ-së për refuzimin e kërkesës për akreditim mund të bëhet ankim administrativ pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, sipas përcaktimeve të nenit 124, pika 1, të Kodit Zgjedhor. Ankimi paraqitet brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e vendimit.

Neni 7

Autorizimi dhe mandati i vëzhguesve

1. Në autorizimin e lëshuar nga KQZ-ja, duhet të përcaktohet:
 - a) Zona Zgjedhore (Qarku ose Bashkia)
 - b) Numrin e KZAZ-së
 - c) Emri, mbiemri i vëzhguesit;
 - ç) Emri i subjektit zgjedhor që e cakton si vëzhgues;
 - d) Zonën ku do të vëzhgojë (KZAZ/QV/VNV).
2. Autorizimi mban vulën e KQZ-së dhe është i firmosur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
3. Vëzhguesit mund të kryejnë vëzhgime vetëm në ambientet zgjedhore të përcaktuar në autorizimin e KQZ-së.

KREU III
AKREDITIMI I VËZHguesVE NGA KZAZ-JA

Neni 8

Delegimi i kompetencës për akreditimin e vëzhguesve

1. Kompetenca e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore sipas nenit 3 të këtij vendimi, mund t'u delegohet Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ-ve).
2. KZAZ-ja akrediton vëzhguesit brenda juridiksionit të saj territorial.
3. Në rast se KQZ ia delegon KZAZ-ve kompetencën e akreditimit të vëzhguesve të subjekteve zgjedhore sipas nenit 3 të këtij vendimi, ndiqen procedurat e përcaktuara në këtë Kre.

Neni 9

Dorëzimi i dokumentacioni për akreditimin e vëzhguesve në KZAZ

1. Subjekti zgjedhore dorëzon pranë KZAZ-së përkatëse dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Kërkesën për akreditimin e vëzhguesve të nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar nga partia politike, partia udhëheqëse e koalicionit apo kandidati i propozuar nga zgjedhësit. Akti i autorizimit depozitohet në KZAZ-në përkatëse;
 - b) Vërtetimin që është regjistruar si subjekt zgjedhor dhe ka regjistruar kandidatë në zgjedhje.
 - c) Listën e vëzhguesve, që kërkohet të akreditohen pranë KZAZ-së/KQV-së/VNV-së përkatëse. Lista duhet të jetë e nënshkruar në çdo faqe nga kryetari i partisë politike ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij, i partisë udhëheqëse të koalicionit ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij, apo nga kandidati i propozuar nga zgjedhësit ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij. Lista dorëzohet sipas modelit KQZ 04 - 19 në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - ç) vetdeklarimin e vëzhguesit për gjendjen gjyqësore, sipas modelit KQZ 04-20, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Kërkesat e subjekteve zgjedhore për akreditimin e vëzhguesve i paraqiten KZAZ-së, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve.
3. Subjekti zgjedhor që dorëzon kërkesën për të akredituar vëzhgues mban përgjegjësi për saktësinë e dokumentacionit të paraqitur dhe për të dhënat personale të paraqitura për secilin prej vëzhguesve të propozuar.

Neni 10

Verifikimi i dokumentacionit dhe vendimmarrja e KZAZ-së

1. KZAZ-ja verifikon dokumentacionit e dorëzuar për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore mbi bazën e të dhënave vetjake të çdo vëzhguesi, brenda 2 (dy) ditëve nga paraqitja.
2. Në rast të konstatimit të mangësive në dokumentacionin e paraqitur, në përmbajtje ose në formë, KZAZ ia kthen për plotësim/korrigjim subjektit zgjedhor përkatës.
3. Dokumentacioni i plotësuar/korrigjuar ridepozitohet pranë KZAZ-së, brenda 24 (njëzetë e katër) orëve nga shpallja e vendimit të kthimit.
4. Verifikimi i dokumentacionit të plotësuar/korrigjuar kryhet nga KZAZ-ja, brenda 24 (njëzetë e katër) orëve nga ridepozitimi i tij.
5. KZAZ, sipas rastit, miraton ose refuzon kërkesën e subjekteve zgjedhore për akreditimin e vëzhguesve, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga paraqitja e tyre.
6. Pas marrjes së vendimit për akreditim, KZAZ-ja pajis vëzhguesit me autorizimin e akreditimit, sipas modelit KQZ 09 – 16, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
7. Vëzhguesit e miratuar me vendim nga KZAZ-ja përkatëse, regjistrohen nga Sekretari i KZAZ-së, në Librin e Protokollit të KZAZ-së.
8. Kundër vendimit të KZAZ-së për refuzimin e kërkesës për akreditim mund të bëhet ankim administrativ pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, sipas përcaktimeve të nenit 124, pika 1, të Kodit Zgjedhor. Ankimi paraqitet brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e vendimit.

Neni 11

Autorizimi dhe mandati i vëzhguesve

1. Në autorizimin e lëshuar nga KZAZ-ja, duhet të përcaktohet:
 - a) Zona Zgjedhore (Qarku ose Bashkia)
 - b) Numri i KZAZ-së
 - c) Emri, mbiemri i vëzhguesit;
 - ç) Emri i subjektit zgjedhor që e cakton si vëzhgues;
 - d) Zona ku do të vëzhgojë (KZAZ/QV/VNV).
2. Autorizimi mban vulën e KZAZ-së dhe është i firmosur nga kryetari dhe sekretari i KZAZ-së.
3. Vëzhguesit mund të kryejnë vëzhgime vetëm në ambientet zgjedhore të përcaktuar në autorizimin e KZAZ-së.
4. Sekretari i KZAZ-së, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas miratimit të autorizimit për akreditimin e vëzhguesve, dorëzon në KQZ në formë elektronike listën e vëzhguesve të akredituar si dhe kopje të vendimmarrjeve të KZAZ-së për akreditimin e tyre.

5. Në përfundim të procesit zgjedhor, KZAZ dorëzon në KQZ vendimmarrjet për akreditimin e vëzhguesve shoqëruar me listën përkatëse dhe dokumentacionin mbështetës të dorëzuar për akreditimin e tyre.

KREU IV

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 12

Revokimi i akreditimit

1. Në rast së kompetenca e akreditimit të vëzhguesve të subjekteve zgjedhore i është deleguar KZAZ-ve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve kryesisht ose me kërkesë së subjekteve zgjedhore revokon vendimet e akreditimit të vëzhguesve të lëshuar nga KZAZ-të.
2. Akreditimet e vëzhguesve të subjekteve bëhet nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ose KZAZ sipas modelit të përcaktuar nga Komisioneri në vendimin e revokimit të akreditimit.

Neni 13

Ankimi dhe hyrja në fuqi

1. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

LISTA E VEZHguesVE

SUBJEKTI ZGJEDHOR _____

Nr	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	DATËLINDJA	NR.I DOK. ID.	KZAZ (vetem)	Specifiko QV-në/ të	KZAZ dhe QV (nje ose me shume spexcifiko)	VNV
1									
2									
3									
4									
5									
6									
7									
8									
9									
10									
11									
12									
13									
14									
15									
16									
17									
18									
19									
20									
21									
22									
23									
24									
25									

Datë _____

Nënshkrimi

Kryetari i partise /perfaqesuesi i koalicionit/kaniddati i propozuar nga zgjedhesit

Vula



Vendimi

Për procedurat dhe kriteret e akreditimit të vëzhguesve të subjekteve zgjedhore në KZAZ, KQV dhe VNV, nga KZAZ-ja, për zgjedhje



MODEL

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

FORMULAR VETËDEKLARIMI

Të dhënat e vetëdeklarimit:

--	--

Mbiemër

Emër

--	--

Atësia

Amësia

--	--

Datëlindja dd/mm/vvvv

Vendlindja

--

Dokumenti i identifikimit (një kopje bashkëngjitur formatit)

Deklaroj me vullnetin tim se jam:

i/e padënuar

i/e dënuar

DEKLARUESI

MARRËSI I VETËDEKLARIMIT

(emër, mbiemër, firmë)

(emër, mbiemër, firmë)

Vulë

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga: _____

(Subjekti i Autorizuar)

Nënshkrimi i deklaruesit autorizues

Data e Nënshkrimit

Shënim. Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 8517 datë 22.07.1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



VËZHgues

I SUBJEKTIT ZGJEDHOR

Kryetar KZAZ
firma

Sekretar KZAZ
firma

ZGJEDHJET PËR ORGANET
E QEVERISJES VENDORE



14.05.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

BASHKIA

KZAZ Nr.

VËZHgues

I SUBJEKTIT ZGJEDHOR

Emër Mbiemër:

Subjekti:

Vëzhgues në:

<input type="checkbox"/>	KZAZ	nr.
<input type="checkbox"/>	KQV	nr.
<input type="checkbox"/>	VNV	nr.



Ilirjan CELIBASHI
Komisioneri Shtetëror
i Zgjedhjeve

ky dokument shoqërohet me mjet identifikimi